



Deklaratë publike për paga të drejta dhe të mjaftueshme për jetesë në Shqipëri: Një domosdoshmëri për mirëqenien dhe drejtësinë sociale

Tiranë, 10 Shtator 2024.

Ne, nënshkruesit e kësaj deklarate, njohim nevojën për paga të denja dhe të drejta për të gjithë punonjësit në sektorin privat dhe publik në Shqipëri. Një pagë e mjaftueshme për jetesë nuk është vetëm një detyrim moral, por edhe një domosdoshmëri ekonomike për të siguruar mirëqenien dhe dinjitetin e punonjësve dhe familjeve të tyre. Ajo kontribuon në prosperitetin afatgjatë të shoqërisë sonë dhe promovon drejtësinë në tregun e punës.

Duke njohur sa vijon:

- Kushtetuta e Shqipërisë¹ mishëron të drejtën për punë dhe jetë të denjë që ka çdo person e cila përfshin aftësinë për të mbështetur veten dhe familjen e tij.
- Kodi i Punës së Shqipërisë përcakton në nenin 111 që... *[paga minimale përcaktohet në bazë: a) të faktorëve ekonomikë, kërkesave të zhvillimit ekonomik dhe zvogëlimit të papunësisë, rritjes së prodhimit; b) të nevojave të punëmarrësve dhe familjeve të tyre, duke pasur parasysh nivelin e përgjithshëm të jetesës së punëmarrësve në vend, të ardhurat e përfituara nga sigurimet shoqërore dhe nivelet e jetesës së grupeve të ndryshme shoqërore].*²
- E drejta për një pagë jetese parashikohet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara³, në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore⁴, në Kartën Sociale Evropiane të Këshillit të Evropës⁵ dhe në shumë dokumente të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
- 25.8 % e punonjësve në Shqipëri marrin pagat minimale⁶, ose thënë ndryshe çdo fund muaji ata shpërblehen me 35,520 lekë⁷. Kjo pagesë nuk pasqyron rritjen e kostove të

¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Online: <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kushtetuta-2012.pdf>

² Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë. Neni 111. Online: <https://qbz.gov.al/preview/c1c18a6c-5f3e-457d-b931-de505b3c7ed0>

³ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Online: <https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524735491-DEKLARATA-UNIVERSALE-E-TE-DREJTAVE-TE-NJERIUT.pdf>

⁴ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Online: <https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524735715-Pakti-Drejtat-Ekonomike-Sociale-Kulturore.pdf>

⁵ Karta Sociale Evropiane, Këshilli i Evropës. Online: <https://rm.coe.int/la-charte-sociale-en-bref/1680a090d3>

⁶ Instituti i Statistikës, Tremujori i parë i vitit 2024. Online: <https://www.instat.gov.al/al/statistika/t%C3%AB-dh%C3%ABna-ky%C3%A7e/>

⁷ Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 40 000 (dyzet mijë) lekë. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera



jetesës, të cilat përfshijnë strehimin, ushqimin, kujdesin shëndetësor dhe arsimin. Kjo gjendje rrit presionin mbi këtë shtresë të popullsisë dhe shton pabarazitë.

- Angazhimi i Shqipërisë ndaj Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDG), veçanërisht SDG 8 (Punë e Denjë dhe Rritje Ekonomike) dhe SDG 10 (Reduktimi i Pabarazive), kërkon miratimin e praktikave të pagave të mjaftueshme për jetesë për të luftuar varfërinë dhe për të promovuar përfshirjen.
- Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP)⁸ koncepti i pagës së jetesës është: niveli i pagës që është i nevojshëm për të përballuar një standard të mirë jetese për punëtorët dhe familjet e tyre, duke marrë parasysh rrethanat e vendit dhe llogaritur punën e kryer gjatë orëve normale të punës. Ky nivel duhet llogaritur në përputhje me parimet e ONP-së për vlerësimin e pagës së jetesës si dhe duhet të arrihet përmes procesit të përcaktimit të pagave në përputhje me parimet e ILO-s për përcaktimin e pagave.

Për arsyt më lart ne paraqesim kërkesat e mëposhtme:

- Punëdhënësit në të gjithë sektorët duhet të sigurojnë një pagë të mjaftueshme për jetesë që pasqyron realisht koston e jetesës në Shqipëri, duke lejuar punëtorët të përballojnë nevojat e tyre thelbësore si ushqimi, strehimi, kujdesi shëndetësor, arsimi dhe transporti.
- Qeveria, bizneset, sindikatat dhe shoqëria civile duhet të angazhohen në një dialog të vazhdueshëm për të përcaktuar standardet e pagave që sigurojnë kushte të denja jetese dhe që i përshtaten ndryshimeve në mjedisin ekonomik.
- Legjislacioni duhet të mbrojë punëtorët nga shfrytëzimi, duke siguruar që pagat të jenë të denja dhe të reflektojnë kërkesat ekonomike.
- Bizneset kanë një detyrë të kontribuojnë në zhvillimin social dhe ekonomik të komuniteteve ku operojnë duke siguruar paga të drejta. Kompanitë duhet të jenë transparente në praktikën e pagave dhe të angazhuara për mirëqenien e punonjësve të tyre.
- Qeveria shqiptare duhet të sigurojë që politikat kombëtare mbështesin një pagë të mjaftueshme për jetesë përmes ligjeve të punës, stimuljeve tatimore dhe masave të tjera të mirëqenies sociale që ulin barrën e kostove të jetesës për punëtorët.
- Një organ i pavarur duhet të krijohet për të monitoruar praktikën e pagave sipas sektorëve dhe për të siguruar përputhshmëri me standardet e pagave të mjaftueshme për jetesë. Ky organ duhet të raportojë rregullisht për përparimin dhe të rregullojë standardet e pagave në përputhje me inflacionin dhe ndryshimet në koston e jetesës.

gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 229,9 (dyqind e njëzet e nëntë pikë nëntë) lekë. Online: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/03/01/113/44a50860-2278-43a8-8835-2206bd468149>

⁸ International Labour Office. March 2024. ILO reaches agreement on the issue of living wages. <https://www.ilo.org/resource/neës/ilo-reaches-agreement-issue-living-wages>



- Duhet të bëhen përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e një page të mjaftueshme për jetesë.

Kjo deklaratë kërkon veprim të menjëhershëm nga të gjithë aktorët e shoqërisë shqiptare, përfshirë qeverinë, punëdhënësit, sindikatat dhe organizatat e shoqërisë civile, për të prioritetizuar zbatimin e një page të mjaftueshme për jetesë. Së bashku, mund të ndërtojmë një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë ku çdo individ ka mundësinë të jetojë me dinjitet dhe siguri.

Emri i Organizatës	Përfaqësuesi ligjor dhe pozicioni
Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim"	Mirela Arqimandriti, Drejtoreshë Ekzekutive
Rrjeti i Organizatave "Zeri i të rinjve"	Andi Rabiçaj, Bashkëthemelues dhe Drejtor Ekzekutiv
Partneret Shqiptarë për Ndryshim dhe Zhvillim	Juliana Hoxha, Drejtoreshë Ekzekutive
Qendra për të Drejtat në Punë	Edison Hoxha, Drejtor Ekzekutiv
Linja e Këshillimit për Gra e Vajza	Iris Luarasi, Drejtore Ekzekutive
Unioni i Sindikatave të Shqipërisë	Kondi Ilia, Koordinator Kombëtar
Sindikata e Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor	Gentian Stroni, Kryetar
Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar	Renato Muçaj, Kryetar
Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve në Shqipëri	Altin Hazizaj, Drejtor i Përgjithshëm
Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Erida Skendaj, Drejtoreshë Ekzekutive
Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT	Xheni Karaj, Drejtoreshë Ekzekutive
Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve	Elma Tershana, Drejtoreshë Ekzekutive
Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve në Shqipëri	Altin Hazizaj, Drejtor i Përgjithshëm
Qendra e Gruas Hapa të Lehtë	Denada Shpuza, Drejtoreshë Ekzekutive
Down Syndrome Albania Foundation	Emanuela Zaimi, Themeluese dhe Drejtoreshë Ekzekutive
Levizja Rinore Egjiptiane dhe Rome	Ervis Çota, Drejtor Ekzekutiv
Shoqata "Gratë në Fokusin e Zhvillimit" Kuçovë	Elsa Rafaeli, Drejtoreshë Ekzekutive
Qendra EDEN	Ermelinda Mahmutaj, Drejtoreshë Ekzekutive
Tjetër Vizion, Elbasan	Arian Çala, Drejtor Ekzekutiv
YWCA of Albania	Donika Godaj, Drejtoreshë Ekzekutive



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Albania Community Assist	Holta Koçi, Drejtoreshë Ekzekutive
Shoqata “Refleksione”	Ani Ruci, Drejtoreshë Ekzekutive
Qendra e Këshillimit të grave dhe Shërbimeve Sociale, Kukës	Vera Istrefaj, Drejtoreshë Ekzekutive
Forumi i Gruas Elbasan	Shpresa Banja, Drejtoreshë Ekzekutive